

	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p><b>Komuna e Prishtinës</b> Opština Priština –Municipality of Prishtina</p>	<p>PRISHTINA</p> 
---	--	--

<b>Datë/a:</b>	22.11.2018
<b>Për/ Za/ To:</b>	Operatori Ekonomik: "EUROFAMIS" sh.a.
<b>CC:</b>	Departamenti i Prokurimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 09.11.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik: "EUROFAMIS" sh.a., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik mbrapa sheshit "Zahir Pajaziti" - Prishtinë, me Nr. të Prok: 616 18 114 521 nxjerr:

## V E N D I M

1. Refuzohet si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik N.N.SH. "CO-ING", të dt. 09.11.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik mbrapa sheshit "Zahir Pajaziti" - Prishtinë, me Nr. të Prok: 616 17 114 521, kundër Njoftimit për anulim të aktivitetit të AK -së, të datës 07.11.2018 të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me propozimin për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik mbrapa sheshit "Zahir Pajaziti" - Prishtinë, me Nr. 616-18-6909-5-2-1, Nr. Brendshëm 616 18 114 521 dhe mbështet njoftimin për dhënie të kontratës lidhur me këtë aktivitet.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

## Arsyetim

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës me datë 14.09.2018 ka bërë njoftimin për kontratë lidhur me tenderin me titull: *"Ndërtimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik mbrapa sheshit "Zahir Pajaziti" - Prishtinë*, me Nr. 616-18-6909-5-2-1, Nr. Brendshëm 616 18 114 521.

Hapja e ofertave nga Autoriteti Kontraktues është bërë me datë: 10.10.2018 ku të pranishëm ishin Operatorët të cilët kanë ofertuar për këtë tender. Janë pranuar 2 oferta. Autoriteti Kontraktues ka respektuar të gjitha dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik lidhur me mbarë vajtjen dhe ecurinë e procesit të hapjes dhe vlerësimit të ofertave.

Me datë 07.11.2018, Autoriteti Kontraktues ka bërë njoftimin e vendimit së bashku me letrat standarde pas vlerësimit të ofertave nga ana e anëtarëve për Komision për Vlerësim ku secili anëtar ka dhënë vlerësimin e tij për çdo kriter të paraqitur në dosje. Me datë 09.11.2018 Operatorit Ekonomik N.N.SH. "CO-ING", iu ka lejuar qasja në dokumentacion të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë lidhur me këtë tender.

Operatori Ekonomik "EUROFAMIS" sh.a., me date 09.11.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit *"Ndërtimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik mbrapa sheshit "Zahir Pajaziti" - Prishtinë*, me Nr. 616-18-6909-5-2-1, Nr. Brendshëm 616 18 114 521, kundër Njoftimit të vendimit së bashku me letra standarde të aktivitetit të prokurimit të AK - së, të datës 07.11.2018 të publikuar në web-faqe të KRPP-së, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë 09.11.2018 sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr.04/L-042, në të cilin pretendon:

- a) *Pretendimi 1: Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë tek deklarata nën betim nuk është shënuar Emri i Operatorëve Ekonomik në rubrikën [operatorët ekonomik që paraqiten].*
- b) *Pretendimi 2: Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar formularin e identifikimit financiar nga Grupi i Operatorëve Ekonomik.*
- c) *Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë tek ing. i ndërtimtarisë nuk janë 3 referenca të natyrës së njëjtë siç kërkohet në FTD. Referencat për ing. duhen të jenë të lëshuara nga kompania ku inxhinieri ka pas marrëdhënie pune.*

d) *Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar listën e makinerisë e kërkuar sipas FTD-së pika 9.1 dhe 9.2, ku kërkohet të plotësohet aneksi 5 d.m.th. nuk e kanë vulosur dhe nënshkruar listën e aneksit nr.5.*

e) *Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë tek kontrata me furnizim me zhavorr ndërmjet operatorëve ekonomik Noti Beton & Mineral LL.C., kontrata nuk është nënshkruar nga NOTI BETON.*

f) *Paramasa nuk është nënshkruar siç duhet nga OE që e përbëjnë konzerciumin*

g) *Plani dinamik nuk është i ofruar në dosje nga Grupi i Operatorëve Ekonomik.*

#### **I. Baza ligjore për refuzim të kërkesës.**

Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësimin e ofertave duke bërë ekzaminimin e të gjitha dokumenteve të prezantuara në ofertat e pranuar.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e ofertave ka zbatuar së pari nenin 6 (Parimi i Efikasitetit dhe Ekonomizimit) dhe nenin 7 (Parimi i Barazisë / jo diskriminimit) të Ligjit për Prokurimin Publik të konsoliduar me Nr. 04/L-042.

Autoriteti Kontraktues hedhe poshtë pretendimin e OE dhe njëherit konfirmon se KK Prishtina ka vlerësuar ofertat ne përputhje me LPP-ne.

**Pretendimi 1: Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë tek deklarata nën betim nuk është shënuar Emri i Operatorëve Ekonomik në rubrikën [operatorët ekonomik që paraqiten].**

Grupi i Operatorëve Ekonomik ka nënshkruar deklaratat nën betim secili prej tyre me çka ka përmbushur kushtet për pjesëmarrje si kriter i parë i FTD-së.

**Pretendimi 2: Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar formularin e identifikimit financiar nga Grupi i Operatorëve Ekonomik.**

Grupi i Operatorëve ekonomik nuk ka përmbushur formularin e identifikimit financiar përshkak se nuk është obligativ dhe nga praktikat e deri tanishme 95% e rasteve vijjnë pa e plotësuar formularin e identifikimit financiar siç ka qenë edhe me rastin e juaj si kompani.

**Pretendimi 3: Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë tek ing. i ndërtimtarisë nuk janë 3 referenca të natyrës së njëjtë siç kërkohet në FTD. Referencat për ing. duhen të jenë të lëshuara nga kompania ku inxhinieri ka pas marrëdhënie pune.**

Autoriteti Kontraktues ka analizuar ofertën e Grupit të OE për rekomandim të dhënies së kontratës me ç'rast ky grup operatorësh ka përmbushur këtë kriter pasi që është kërkuar si dëshmi Curriculum Vitae (CV) dhe Kontrata e nuk është kërkuar Referenca.

**Pretendimi 4: Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar listën e makinerisë e kërkuar sipas FTD-së pika 9.1 dhe 9.2, ku kërkohet të plotësohet aneksi 5 d.m.th. nuk e kanë vulosur dhe nënshkruar listën e aneksit nr.5.**

Autoriteti Kontraktues konstaton se Grupi i Operatorëve Ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës ka pasur listën e tij jashtë aneksit 5 me ç'rast ka përmbushur kriterin pasi që lista e përpiluar nga vet Operatorët Ekonomik është e pranueshme.

**Pretendimi 5: Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë tek kontrata me furnizim me zhavorr ndërmjet operatorëve ekonomik Noti Beton & Mineral LL.C., kontrata nuk është nënshkruar nga NOTI BETON.**

Autoriteti Kontraktues ka verifikuar dhe analizuar gjatë vlerësimit të tenderëve se Grupi i OE i rekomanduar për kontratë ka vulën dhe nënshkrimin me OE Mineral LL.C. për furnizim me zhavorr si dhe ka licencën për zhavorr OE Mineral LL.C.

**Pretendimi 6: Paramasa nuk është nënshkruar siç duhet nga OE që e përbëjnë konzerciumin**

Autoriteti Kontraktues në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik dhe Udhëzuesit Operativ ka vlerësuar se Lideri i Grupit i Operatorëve Ekonomik ka nënshkruar paramasën me cka ka përmbushur kërkesat nga FTD-ja.

**Pretendimi 7: Plani dinamik nuk është i ofruar në dosje nga Grupi i Operatorëve Ekonomik.**

Autoriteti Kontraktues asnjëherë nuk ka kërkuar sjelljen e Planit Dinamik nga OE gjatë ofertimit mirëpo pas përzgjedhjes së Operatorit Ekonomik për dhënie dhe nënshkrim të kontratës kërkojmë planin dinamik në bashkëpunim me menaxherët e kontratës.

Andaj duke u bazuar në të gjitha provat dhe argumentet e prezantuara si dhe duke zbatuar dhe respektuar Ligjin për Prokurimin Publik, Rregullat e Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik si dhe **Rregullat për tenderët jo-normalisht të ulët**, Autoriteti Kontraktues vendos si në dispozitivin e cekur më lartë.

**Këshilla juridike:**

*Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.*

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

